

KUSHTET E SHËRBIMIT TË REGJISTRIMIT AUTOMATIK

Me blerjen e shërbimit të regjistrimit automatik njëherësh pranoni dhe bini dakord se kushtet aktuale vlejnë për ju dhe për pasagjerët në rezervimin/prenotimin tuaj.

1. INTERPRETIMI

1.1. Kushtet dhe shprehjet e përkufizuara në Kushtet e përgjithshme të transportit të Wizz Air do të kenë të njëjtin kuptim kur përdoren në këto Kushte të përgjithshme përveçse kur përcaktohet ndryshe më poshtë ose kur e kërkon ndryshe konteksti.

1.2. Përkufizimet - "Kushtet e përgjithshme të transportit" janë kushtet e përgjithshme të transportit të "Wizz Air Hungary Ltd" dhe/ose të "Wizz Air UK Ltd" në varësi të fluturimit për të cilin blihet shërbimi i regjistrimit automatik, siç këto publikohen në Faqen e internetit dhe siç ndryshohen nga subjekti përkatës i Wizz Air me kalimin e kohës.

1.3. "Ju" ose "rezervuesi" është individ i moshës madhore dhe që ka zotësi të plotë ligjore ose një person juridik që vepron si agjent për pasagjerin dhe që kryen prenotimin në emrin e tij/saj dhe për llogari të tij/saj dhe/ose në emrat e pasagjerëve të tjerë dhe për llogari të tyre, si dhe që merr përsipër detyrimet e përcaktuara në klauzolat 6.1.4 - 6.1.7 të kushteve të përgjithshme të transportit. Rezervuesi përfshin gjithashtu një individ ose kompani që na paguan neve tarifën e plotë të fluturimit siç tregohet në itinerarin e një pasagjeri dhe të agjencive të udhëtimit.

1.4. "Shërbimi i regjistrimit automatik" ose "regjistrimi automatik" është shërbimi ynë që ofrohet sipas dhe në përputhje me kushtet aktuale, i cili ju jep të drejtën juve dhe pasagjerëve në rezervimin/prenotimin tuaj që të regjistroheni automatikisht kundrejt një tarife regjistrimi automatik.

2. SHËRBIMI I REGJISTRIMIT AUTOMATIK

2.1. Regjistrimi automatik mund të blihet në faqen e internetit ose përmes aplikacionit për celular Wizz Air gjatë rezervimit/prenotimit të fluturimit tuaj ose mund të shtohet në një rezervim/prenotim ekzistues 4 orë përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj. Për shmangien e dyshimeve, "orari i planifikuar i nisjes" është orari që ju është komunikuar në çastin e rezervimit/prenotimit apo më vonë, nga Wizz Air për shkak të ndryshimeve në orar. Vonesat nuk mund të konsiderohen si ndryshim orari. Për qartësi, blerja e regjistrimit automatik duhet përfunduar (d.m.th. duhet kryer pagesa) 4 orë përpara kohës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj.

2.2. Regjistrimi automatik mund të blihet në mënyrat e mëposhtme:

- mund të shtohet në biletën Basic ose në WIZZ GO gjatë rezervimit/prenotimit të fluturimit tuaj ose mund t'i shtohet prenotimit tuaj ekzistues; ose

- mund të blihet si pjesë e WIZZ Plus (nëse përfshihet në WIZZ Plus). Vini re se në rast se WIZZ Plus blihet brenda 4 orëve nga orari i planifikuar i nisjes së fluturimit tuaj, shërbimi i regjistrimit automatik nuk përfshihet në WIZZ Plus.

2.3. Nëse zgjidhni regjistrimin automatik, ky do të vlejë për të gjitha fluturimet dhe të gjithë pasagjerët në rezervim/prenotim, dhe tarifa e shërbimit do të përlllogaritet sipas e në përputhje me numrin e pasagjerëve dhe të fluturimeve.

2.4. Vini re, se për t'u regjistruar me sukses përmes regjistrimit automatik, duhen paraqitur të dhënat e mëposhtme:

- detajet e dokumenteve tuaja dhe të të gjithë pasagjerëve shoqërues (përveç rasteve të udhëtimit nga një vendnisje në zonën Shengen drejt një vendmbërritjeje në zonën Shengen);

- një numër telefoni në rast të udhëtimit nga një vendnisje në zonën Shengen drejt një vendmbërritjeje në zonën Shengen;

2.5. Përmes blerjes së regjistrimit automatik për juve dhe pasagjerët në rezervimin/prenotimin tuaj (nëse ka) procesi i regjistrimit do të kryhet automatikisht 50 orë përpara orarit të planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj, nëse keni paraqitur të dhënat e nevojshme (sipas klauzolës 2.4. të kushteve aktuale). Të dhënat e përcaktuara në klauzolën 2.4. mund t'i paraqisni deri në 4 orë përpara orarit të planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj për t'u regjistruar automatikisht përmes shërbimit të regjistrimit automatik, p.sh. të përfitoni nga shërbimi.

2.6. Pasi ju dhe pasagjerët në rezervimin/prenotimin tuaj (nëse vlen për rastin) të jeni regjistruar, ju do të merrni lejet e imbarkimit në përputhje me sa më poshtë:

- në rastin e prenotimeve prej deri në 10 persona lejet e imbarkimit do t'ju dërgohen me email në adresën e emailit të përcaktuar në llogarinë tuaj të WIZZ;

- në rast prenotimesh mbi 10 personash (prenotime në grup) (detajet mund t'i gjeni këtu: <https://wizzair.com/en-gb/information-and-services/booking-information/group-bookings/terms-and-conditions>) lejet e imbarkimit do të ofrohen dhe mund të shkarkohen nga llogaria e WIZZ e rezervuesit;

- në rastin e prenotimeve të kryera nga agjencitë e udhëtimit, lejet e imbarkimit të pasagjerëve do të ofrohen te llogaria dhe mund të shkarkohen nga llogaria e WIZZ e agjencisë së udhëtimit;

2.7. Regjistrimi automatik mund të blihet vetëm për ato fluturime ku regjistrimi nga interneti lejohet dhe pritet nga aeroporti i nisjes. Lista e aeroporteve ku nuk ofrohet regjistrimi nga interneti mund të gjendet këtu: <https://wizzair.com/en-gb/information-and-services/booking-information/check-in-and-boarding>

2.8. Nëse pas regjistrimit automatik keni blerë ndonjë shërbim në rezervimin/prenotimin ekzistues apo keni kryer ndonjë ndryshim në lidhje me rezervimin/prenotimin ekzistues, leja e re (e përditësuar) e imbarkimit do t'ju dërgohet automatikisht sipas klauzolës 2.6. të kushteve aktuale.

2.8.1. Në rast se e [ndryshoni rezervimin tuaj](#), leja e re e imbarkimit do t'ju dërgohet sipas klauzolës 2.6. të kushteve aktuale pas përfundimit të ndryshimit të rezervimit tuaj, nëse aeroporti i ri i nisjes (aeroporti që keni zgjedhur si vend të ri nisjeje) pranon dhe lejon regjistrimin automatik.

2.9. Shërbimi i regjistrimit automatik ofrohet sipas mundësisë.

2.10. Shërbimi ofrohet vetëm për rezervimet e kryera përmes wizzair.com ose aplikacionit Wizz Air për celularë.

3. TARIFA E REGJISTRIMIT AUTOMATIK

3.1. Regjistrimi automatik ka një tarifë për fluturim për pasagjer në rezervim/prenotim.

3.2. Rimbursimi

3.1.1. Tarifa e regjistrimit automatik rimbursohet në rastet e mëposhtme:

- në rast se fluturimi ju është anuluar nga Wizz Air;

- në rast se e anuloni rezervimin mbi 14 ditë përpara datës së planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj;
- në rastet kur tarifa e fluturimit duhet t'ju rimbursohet sipas kushteve të përgjithshme të transportit

3.1.2. Në rastet që nuk përcaktohen shprehimisht në klauzolën 3.1.1. të kushteve aktuale tarifa e regjistrimit automatik nuk mund të rimbursohet.

Për të shmangur dyshimet,

- nuk mund të kërkohet rimbursim tarife regjistrimi automatik në rast se e anuloni rezervimin/prenotimin brenda 14 ditëve nga data e planifikuar e nisjes së fluturimit;
- nuk mund të kërkohet rimbursim tarife regjistrimi automatik në rast se regjistroheni manualisht për veten dhe/ose për pasagjerët në rezervimin/prenotimin tuaj;
- nuk mund të kërkohet rimbursim tarife regjistrimi automatik në rast se të dhënat e përcaktuara në klauzolën 2.4. nuk jepen deri në 4 orë përpara orarit të planifikuar të nisjes së fluturimit tuaj;

3.3. Tarifa e regjistrimit automatik do të përcaktohet në monedhën e biletës ose të paketës, që do të thotë në monedhën e vendnisjes, përveç nëse përcaktojmë një monedhë tjetër gjatë pagesës ose përpara kohës së pagesës, ose nëse zgjidhni të paguani në një monedhë tjetër. Fatura lëshohet në monedhën e vendit të nisjes.

3.4. Çmimet e treguara në një monedhë të caktuar në faqen tonë të internetit ose në aplikacionin WIZZ për celularë janë të vlefshme vetëm nëse ajo monedhë është monedha e vendnisjes së fluturimit të zgjedhur siç përcaktohet nga Wizz Air. Nëse zgjidhni të paguani në një monedhë tjetër, çmimi do të konvertohet prej nesh.

4. TË TJERA

5.1. Wizz Air rezervon të drejtën të kufizojë ofrimin e regjistrimit automatik.

5.2. Në lidhje me të dhënat personale që na keni paraqitur gjatë procesit të regjistrimit automatik, ne veprojmë në përputhje me ligjet përkatëse të mbrojtjes së të dhënave në lidhje me të dhënat personale që na janë dhënë. Deklarata jonë e privatësisë ofrohet në faqen tonë të internetit.

5.3. Përveçse kur përcaktohet ndryshe nga ndonjë dispozitë e detyrueshme e ndonjë ligji të zbatueshëm, mbi këto kushte vepron legjislacioni i Hungarisë. Çdo mosmarrëveshje mes jush dhe nesh në lidhje me këtë shërbim në çdo mënyrë të mundshme do t'i nënshtrohet juridiksionit joekskluziv të gjykatave të Hungarisë. "Juridiksion joekskluziv" do të thotë se mund të ngrini padi ndaj nesh në një juridiksion jashtë gjykatave të Hungarisë